



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

të mbledhjes së katërt të Kuvendit, mbajtur më 10.08.2020, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Adrian Berisha (PSD), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Kreshnik Smajlaj (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknate Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (i pavarur) dhe Granit Shala (Nisma).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Naim Hoxha ( LVV), Nazlie Bala (LVV) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkyetar i Komunës, Ardian Olluri, drejtës i Drejtorisë së Urbanizmit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Bujar Gashi, drejtës i Drejtorisë së Shëndetësisë, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Shkumbin Gashi, drejtës i Drejtorisë së Bujqësisë, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve, si dhe drejtës i Bordit të NPL "Pallati i Rinisë".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoj **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.  
Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, kryesuesi i ftoi anëtarët e rinj të Kuvendit, Granit Shala, nga subjekti politik NISMA dhe Kreshnik Ismajlaj, nga subjekti politik AAK, që ta bëjnë betimin para Kuvendit.  
Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Faqe 1 nga 14

**Halim Halimi** bëri vërejtje lidhur me materialin, duke thënë se materialet të cilat përgatiten për anëtarët e Kuvendit duhet të dërgohen me kohë dhe të dërgohen komplet. Kjo nuk është hera e parë që sillet materiali në këtë mënyrë, por kemi edhe shumë herë të tjera kur materialet e Kuvendit na vijnë pjesë – pjesë. Andaj, kërkoj që materialet për Kuvend të përgatiteni dhe të dërgohen me kohë.

**Kryesuesi** tha se sa i përket materialeve që kanë ardhur me vonesë, pra është fjala për plotësimin e raportit të NPL “Pallati i Rinisë”, që ka ardhur si rezultat i vërejtjeve që janë dhënë në mbledhjen e KPF-së.

**Leutrim Retkoceri** propozoi që në rend të ditës të shtohet edhe një pikë: “Deklaratë për mbrojtje të vlerave dhe udhëheqësve të UCK-së”.

**Sami Boroci** propozoi që në rendë të ditës të futet për diskutim kërkesa, që klubeve të Hajvalisë t'iu lejohet shfrytëzimi i stadiumit të futbollit të Hajvalisë.

**Kryesuesi** tha se sa i përket këtij propozimi, tash për tash jemi të papërgatitur, pasi që paraprakisht për këtë kërkesë duhet të sillen materiale dhe argumente që do ta faktionin këtë kërkesë.

**Vala Peshku** tha se sa i përket propozimit të Leutrimit, do doja që të kishim një elaborim se çka është ajo deklaratë, se si e tillë është e panjohur për mua së paku. Pra, pse duhet Kuvendi i Komunës me u marrë me një deklaratë të tillë.

Ndërsa për kërkesën e Samiut, ne së pari duhet parë se cilat janë marrëdhëniet kontraktuale të Federatës me Klubin e futbollit të Hajvalisë, a ka ndonjë marrëveshje, edhe pse nuk lejohet që ekipet e tillë të Hajvalisë ta përdorin atë stadium, dhe cila është fuqia e Federatës sipas kontratës që tua ndalojë atyre.

**Egzon Azemi** propozoi që si pikë në rend të ditës të jetë edhe diskutimi për problemin e qytetarëve me transportin publik, që është shumë real, si në lagje dhe fshatra të ndryshme të Prishtinës, siç janë Llukari, Makovci edhe shumë pjesë të tjera që gravitojnë në territorin e komunës së Prishtinës. Këto linja, e në veçanti linja “7 B” janë shumë të rralla dhe si pasojë e kësaj autobusët stërmbrushen me udhëtarë, andaj dhe krijohen gjasat shumë të mëdha me u infektuar me COVID -19. Më mirë do të ishte të diskutonim sot për problemet reale që janë duke ndodhur tash për tash, sesa për disa çështje që po ngritën nga disa asamblistë.

**Shefki Gashi** kërkoi të dijë se me vendim të kujt është vendosur që të mos shtypet materiali në letër. Ai kërkoi që të votohet në asamble se duan apo nuk duan materialin e mbledhjes të printuar në letër. Si pasojë e kësaj, total jemi të papërgatitur për pikat e rendit të ditës, sepse nuk e kemi materialin përpëra asnjeri.

**Kryesuesi** dha sqarim për këtë, duke thënë se çështjen e shtypjes së materialeve në letër, konsideroj se e kemi mbyllur më herët. Ka qenë një dakordim i përgjithshëm, prandaj edhe kemi marr vendim që me i pasur llap-topat për mos me shtypur letër.

**Agim Gashi** propozoi që për mbledhjen e radhës së Kuvendit, të sillet Propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Anton Çettës.

**Vlora Dumoshi** tha se sa i përket kërkesës së klubeve të Hajvalisë për shfrytëzimin e satadiumit të Hajvalisë, propozoj që atë kërkesë ose ankesë, ta drejtoni edhe në Ministrinë e Kulturës, ku unë, në cilësinë e ministres së këtij dikasteri, do të angazhohem që në kontakt me Federatën e Futbollit ose me Komitetin Olimpik, kjo kërkesë të marrë një rrugë të drejtë.

Lidhur me çështjen e ngritur rrëth shfrytëzimit të stadiumit të Hajvalisë edhe nga klubet e tjera të Hajvalisë, Shpend Ahmeti, kryetar, dha sqarime të nevojshme. **Osman Bllaca** tha se për këtë mbledhje kemi propozuar edhe Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, të datës 28.02.2013. Sipas këtij ndryshimi, nënkupton lirimin e pagesave të ngarkesave vjetore për vitin 2020, për shkak të situatës së pandemisë COVID -19, për veprimtaritë ekonomike, ndërmarrjet e shërbimeve hoteliere dhe motelet.

**Ardian Berisha** u shpreh i pajtimit me propozimin e Egzonit, që në pikë të rendit të ditës me qenë edhe një diskutim për gjendjen për pandemi në komunën e Prishtinës, ku ne si legjislativ kishim mundur me dhënë disa propozime për ekzekutivit, ku në veçanti do të diskutonim rrëth mundësisë për ndihmë bizneseve të ndryshme.

**Fiknete Bejta** propozoi që pika e dytë e rendit të ditës "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa", të shtyhet për seancën e ardhshme, pasi që përbërja e këtij komiteti nuk paraqet përbërjen reale të grupeve të asamblistëve në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Po ashtu, e përkrahu propozimin e Egzonit dhe Ardianit për trajtimin e çështjes së pandemisë, si çështje me urgjencë.

Një çështje që vlen për ta diskutuar, është edhe Qendra për shërbim me qytetarë, ku po kemi tollovi në hyrje të Komunës për shkak të shpërndarjes së numrave. Kam konstatuar se ka mundësi të keqpërdorimit të shpërndarjes së atyre numrave, andaj ne duhet t'i diskutojmë këto çështje.

**Egzon Azemi** tha se kemi marrë një ankesë nga bizneset e zejtarëve të Prishtinës, të cilët janë ankuar se, përkundër kushteve të rënda që i kanë, nuk kanë pasur asnjë masë lehtësuese gjatë periudhës së pandemisë. Besoj se ishte dashur me i përfshirë, për shkak se është një numër shumë i vogël i këtij lloji të biznesit që po vazhdon me mbetur në Prishtinë.

**Mirsad Vitija** theksoi se stadiumi i ndërtuar në Hajvali nuk i takon klubit futbollistik "Hajvalia". Këtu, në këtë Kuvend, më 08.07.2019, është marrë një vendim, ku ai stadium për dyzet vjet do t'i jepet në shfrytëzim Federatës së Futbollit të Kosovës dhe në atë kohë unë nga radhët e LVV-së kam ngritur një çështje, ku dhe kam kërkuar që të futet apo të hyjë në atë rregullore, që: "Klubeve të Hajvalisë t'iu lejohet shfrytëzimi i stadiumit të futbollit të Hajvalisë dhe të kenë të drejtën e shfrytëzimit të stadiumit pa kompensim, përfshirë të gjitha grup-moshat, shkollën e futbollit "Hajvalia", si dhe klubin futbollistik përfshirë". E përkrah propozimin e Samiut, që klubeve të Hajvalisë t'iu lejohet shfrytëzimi i stadiumit të futbollit të Hajvalisë.

**Hafiz Krasniqi** u shpreh se duke pasur parasysh vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë nga parafolësit, propozoj që para çdo mbledhje, grupet parlamentare dhe komitetet duhet të takohen deri sa të mbahet Komiteti për Politikë dhe Financa, pasi që në KPF shoshiten të gjitha pika e rendit të ditës, na prezantohen ashtu që edhe ne si asamblistë mund ta japim kontributin, përpos pikave të caktuara që janë urgjente, që mund të lindin prej momentit kur është mbajtur KPF-ja deri në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e parë: "Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale", 01. nr. 110- 21449, i dt. 28.02.2013.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110 - 21449, i dt. 28.02.2013, hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dytë: "Deklaratë për mbrojtjen e vlerave dhe ushtarëve të UÇK-së.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që Deklarata për mbrojtjen e vlerave dhe ushtarëve të UÇK-së, hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi e hodhi në votim edhe propozimin që pikë e dytë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa", të shtyhet për diskutim për seancën e radhës.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 36 anëtarë të Kuvendit. Më 8 vota për, 14 kundër dhe 3 abstenime, kjo pikë mbetet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se prezent janë 36 anëtar të Kuvendit. Më 25 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Raporti vjetor i NPL "Pallati i Rinisë", SHA, për vitin 2019;
4. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill- 30 qershor 2020 (TM2);
5. Deklaratë për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës;
9. Diskutim publik mbi Propozimrregulloren për definimin e parametrave urbanë, arkitektonik të ndërtimit dhe hapësirave gjelbëruese;

10. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr.110-21449/20, dt. 28.02.2013;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Agim Gashi bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se kur votojmë për një vendim të caktuar, nëse nuk janë 26 vota për, ose nuk bëjnë më shumë se 26 vota në tri rastet *për*, *kundër* dhe *abstenim*, duhet konstatuar se sa pjesëmarrës marrin pjesë në votim, përndryshe krijon përshtypje se nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm në votim.

Kryesuesi konstatoi se 33 anëtarë janë prezent dhe më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**Pika e dytë**

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Egzon Azemi, për anëtare të KPF-së nga radhët e GP të LVV-së e propozoj Leonora Shabani- Bajraktarin.

Kumrije Shabani, për anëtar të KPF-së nga radhët e GP të PDK-së e propozoj Leutrim Retkocerin.

Lidhur me këtë pikë sqarime shtesë dha kryetari, Shpend Ahmeti.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, 2 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Pika e tretë**

Raporti vjetor i NPL "Pallati i Rinisë", SHA, për vitin 2019.

Lidhur me Raportin vjetor të NPL "Pallati i Rinisë", SHA, për vitin 2019, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Mimoza Sylejmani, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve të Kuvendit. Ajo fillimisht bëri një elaborim rrëth historikut të statusit të kësaj ndërmarrje. Ajo tha se në shtator të vitit 2018, Komuna e Prishtinës ka bërë marrëveshje me AKP-në për kalimin e pronësisë në Komunën e Prishtinës, prandaj ka shkuar si propozim në Kuvendin e Kosovës, ku më 20.03.2018 është votuar, dhe kjo ndërmarrje kalon në menaxhimin e Komunës së Prishtinës. Në fillim kemi hasur në shumë vështirësi, por me formimin e organeve të reja të kësaj ndërmarrje, gradualisht janë konsoliduar gjërat dhe tani mund të konstatojmë një gjendje normale në këtë ndërmarrje.

**Halim Halimi** tha se prej momentit që kjo ndërmarrje është kthyer në pronësi të Komunës, ka filluar të bëhet diçka në të mirë, ndoshta jo aq shumë, por kjo ndërmarrje filluar të bie në binarë, edhe at duke iu falënderuar subvencionit prej 3 milionë euro nga Komuna, kështu që edhe Bordit edhe aksionarëve iu ka dhënë një mundësi që të fillojnë të punojnë ndoshta më shumë.

Si GP kemi bërë vërejtje, se ky bord është dashtë t'i bëjë disa punë elementare, si në hartimin e rregulloreve e tjera, e tjera, por, megjithatë, pa hy në detaje, ky bord ka punuar aq sa ka mundur.

**Egzon Azemi** kërkoi të dijë nga aksionarët e kësaj ndërmarrjeje se a e dinë realisht vlerën e saktë të ndërmarrjes publike, për shkak se te Raporti i auditorit po specifikohet që kjo ndërmarrje nuk ka dokumente që e saktësojnë, e dokumentojnë vlerën reale për mbi 3 milionë euro, por nuk kanë dokumentacion të mjaftueshmë që e dëshmon këtë pasuri. Po ashtu, çfarë kanë ndërmarrë aksionarët ose Bordi drejtorëve te pikat ku shihet që ka jashtëzakonisht pak të ardhura, e kur i dimë potencialet dhe pozicionet e ndërmarrjes, kështu që e dimë se resurset janë shumë më të mëdha, p.sh. të hyrat nga reklamat, si dhe të hyra nga shërbime të tjera etj.

**Suzan Kika** pyeti se a është diskutuar në mes të aksionarëve dhe Bordit të ndërmarrjes çështja e ndërtimit të Shkollës së Muzikës në objektin e Pallatit të Rinisë, çka do të bëhet, dhe kur do të fillojë ndërtimi i kësaj shkolle.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit rrreth gjendjes në NPL "Pallati i Rinisë", sqarime të nevojshme dha kryetari, Shpend Ahmeti.

**Agim Gashi** theksoi se sa i përket raportit të ndërmarrjes "Pallati i Rinisë", është mirë të vlerësojmë se ky Kuvend ka zgjedhur përfaqësuesit e vetë, bashkë me përfaqësuesit e qeverisë komunale dhe këta kanë bërë një punë të mirë, ashtu siç i obligon edhe ligji. Disa dukuri që me dekada e kanë përcjellë këtë ndërmarrje, pra eliminimi i atyre dukurive të këqija nënkuption se ata njerëz që po shërbejnë aty, qoftë përfaqësues të Bordit, qoftë në mbikëqyrje të aksionarëve, qoftë pjesa tjetër e ekzekutivit në ndërmarrje janë këndellur dhe po e stabilizojnë ndërmarrjen.

**Sami Salihu** tha se në bazë të këtij rapporti shihet një menaxhim shumë më i mirë, që ka filluar të rimëkëmbet kjo ndërmarrje, por duke pasur parasysh situatën aktuale me të cilën po përballen bizneset në këtë kohë pandemie, edhe bizneset të cilat operojnë në "Pallatin e Rinisë" janë mjaft të prekura, kërkoi nga aksionarët që të merren masa lehtësuese për në pagesat e qirasë, pra për uljen e tyre për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim që të rimëkëmben ato biznese.

Njëherësh ai kërkoi nga bordi aktual, që t'i publikoj civitë (CV-të) e veta, që ne ta shohim se a i kanë plotësuar të gjitha kriteret për të qenë pjesë e Bordit.

**Hafiz Krasniqi** shprehu mendimin se duke u bazuar në këtë raport, shihet se Bordi i drejtorëve dhe aksionarët me një përkushtim dhe profesionalizëm i kanë kryer detyrat e tyre të punës. Pra, shihet se kanë qenë mjaft aktivë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore. Sa i përket Raportit të auditorit, shihet se është munduar që t'i paraqesë të gjitha pasqyrat e të ardhurave, shpenzimeve materiale dhe operative, pasqyrat rrjedhëse të

parasë, pasqyrat mbi pasuritë dhe detyrimet e të tjera. Në report janë të prezantuar të dhënrat, komplet, sipas asaj që është në raportin financiar, dhënë nga zyrtari financiar, për arsy se mungon ajo pjesë ku është dashtë të japë rekomandime në kode të caktuara dhe në zëra operativë, por kryesisht është bazuar në raportin financiar dhe, si të tillë, unë e kisha vlerësuar si rapport financiar sesa ndoshta rapport i auditorit.

Si përfundim, përgëzoj Komunën që dalëngadalë në të gjitha kompanitë ka filluar të krijojë një disiplinë dhe stabilitet menaxherial, që është edhe kontribut i Kuvendit të Komunës, por njëkohësisht edhe i menaxhmentit të ndërmarrjes.

Rifat Deri i falënderoi anëtarët e Komisionit të aksionarëve dhe anëtarët e Bordit të kësaj ndërmarrje për informatën që e dhanë mbi gjendjen në ndërmarrjen "Pallati i Rinisë". Në veçanti është për t'u falënderuar z. Polloshka, kryesues i Bordit, për punën të cilën e kanë bërë. Shpresojmë që vitin e ardhshëm do të kemi një report edhe shumë më të mirë, sepse i pret një punë e madhe dhe e frytshme, kështu që të gjitha këto që i dëgjuam, prapa tyre qëndroj edhe unë, pra po shihet se një dritë e madhe po ndriçon në lidhje me këtë ndërmarrje, e cila faktikisht është një lloj ikone e kryeqytetit të Kosovës.

Shefqet Osmani, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve, tha se është për t'u falënderuar angazhimi i të gjithëve që kanë kontribuar në mëkëmbjen e kësaj ndërmarrjeje, të cilët e kanë bërë të pamundurën që Pallati me qenë këtu ku është sot, e që është bërë një punë e jashtëzakonshme dhe është hera e parë që është bërë një report i auditimit. Kjo ndërmarrje nuk ka pasur kurrë as Bord, as auditim, kështu që as këta nuk kanë pasur mundësi me dhënë informacione. Me ndarjen e mjeteve nga Kuvendi i Komunës, ndërmarrja ka filluar të rimëkëmbet, por si objekt që është, konsideroj që është në një gjendje të mjerueshme, ku për brenda është shumë i shkatërruar, edhe aty duhen shumë mjete, shumë investime. Duke pasur parasysh situatën në këtë kohë të pandemisë, besoje se bashkërisht me Bordin dhe kryeshefin ekzekutiv, do t'i u dalim në ndihmë atyre bizneseve. Pra, do të gjejmë alternativë dhe mundësi edhe do të bëjmë një zgjidhje si Komunë e Prishtinës për shumë ndërmarrje tjera dhe ne do t'u bëjmë lehtësira atyre bizneseve.

Adrian Berisha tha se jam shumë i kënaqur si qytetar i Prishtinës, që "Pallati i Rinisë" iu kthyte qytetit të cilit i përket, kjo është kënaqësi e jashtëzakonshme pozitive, sepse ne e dimë të gjithë çka ka ndodhur me atë pallat, qysh kanë tentuar me e djegur e me privatizuar përmes AKP-së e tjera, e tjera. Jam shumë falënderues për punën që kanë bërë Komisioni komunal i aksionarëve dhe Bordi, përmes Arben Polloshkës, si kryeshef ekzekutiv.

**Kryesuesi konstatoi se prezent janë 32 anëtarë të Kuvendit. Më 25 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Raporti vjetor i NPL "Pallati i Rinisë", SHA, për vitin 2019.**

#### Pika e katërt

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill- 30 qershor 2020 (TM2).**

Agim Gashi bëri të ditur se GP i LDK-së me vëmendje e ka analizuar gjashtëmujorin, përkatësisht tremujorin e dytë, pavarësisht se jemi në rrethana emergjente, në rrethana të rënda të cilat kanë prekur çdo pore të jetës institucionale, pasqyrat financiare që

Faqe 7 nga 14

paraqiten këtu, na bëjnë pak sa të them skeptik, për arsyen se duke filluar që nga të hyrat e deri tek shpenzimet, përqindjet janë të vogla dhe janë jo premtuese. Sa i përket të hyrave, shihet se ka një rënje në tremujorin e dytë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, por në krahasim edhe me TM 1, ka një rënje, ku totali del diku 35.63%, që është një përqindje shumë e ulët për gjashtëmujorin, dhe se kjo pastaj e çrrégullon komplet skemën planifikuese të investimeve të buxhetit përmes buxhetit vjetor.

Sa i përket realizimit të shpenzimeve të buxhetit, këtu nuk është fajtor krejt pandemia, për arsyen se ne kemi pasur diku mbi 27 milionë euro bartje nga viti i kaluar dhe se ato kanë qenë para të gatshme për shpenzime, vetëm se është dashur që të vërtetohen projektet dhe të ecët përpëra, sidomos në investimet kapitale, siç janë rruga "A", kolektorët, kanalizimet, ndërtimi i objekteve shkolllore, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe gjëra të tjera për të cilat Komuna e Prishtinës ka shumë nevojë.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, qeveria komunale duhet të mobilizohet që në periudhën e tretë, në tremujorin e tretë dhe të katërt të koncentrohet te investimet kapitale, sepse paratë i kanë, projektet janë, shumica e tyre të kontraktuara, dhe është mirë të kërkohet nga Qeveria të ketë një rishikim, diku nga fillimi i shtatorit, në mënyrë që ato pak mjete vetanake të mos na barten prej vitit, por të orientohet në projektet e mëdha kapitale.

**Leonora Shabani- Bajraktari** theksoi se për çdo ditë shihet mospuna e qeverisë lokale të Komunës së Prishtinës. Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës vitin e kaluar, shihet se as 25% nuk ka arritur t'i zbatojë projektet e planifikuara. Këtë më së miri mund ta shohim te disa nga drejtoritë komunale, si Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Pronës, që kanë realizuar 0% të projekteve të planifikuara. Po ashtu, edhe drejtoritë e tjera kanë shpenzuar shumë pak mjete për realizimin e projekteve. Sipas organizatës INPO, të cilët e kanë monitoruar punën e prokurimit publik në Komunën e Prishtinës, 35% të aktiviteteve të prokurimit janë zhvilluar sipas procedurës të negociuar, pa publikimin e njoftimit për kontrata, andaj kërkoi shpjegim se pse ka ndodhur një praktikë e tillë.

**Hafiz Krasniqi** fillimisht e përgëzoi drejtoreshën e Financave për raportin, njëkohësisht për përparimin që po bën në këto raporte, për arsyen se nga periudha rapportuese deri në periudhën tjetër, thuajse ka filluar të bëhet zgjerimi i gamës së shpjegimeve të pozicioneve të caktuara, kështu që edhe ne si Kuvend, edhe si këshilltarë po e kemi më lehtë të orientohemi.

Ndikimi i gjendjes së pandemisë tanë ka prekur performancën e të gjitha komponentëve vlerësues si të hyrave ashtu edhe të gjitha llojeve të shpenzimeve, e veçmas të atyre kapitale.

Në radhë të parë, të hyrat e Komunës gjatë tremujorit të dytë janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 13.54%, e në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, kemi rënje prej 50. 66 %. Ndërsa sa i përket performancës së shpenzimeve buxhetore, gjendja është edhe më e rëndë e shumë më e theksuar tek shpenzimet kapitale, ku kemi realizim vetëm 6.92% në krahasim me planifikimin, dhe 22.69% më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit 2019. Po ashtu, shqetësuese është edhe bartja e 27 milionë

euro, ku për investime kapitale janë mbi 23 milionë euro dhe janë realizuar vetëm 9.56% të mjeteve buxhetore.

**Vala Peshku** tha se duke pasur parasysh situatën e krijuar nga muaji mars e deri në fund të muajit maj, asgjë nuk është punuar, asgjë nuk ka qenë e lejuar, e që kjo situatë ka reflektuar edhe në buxhetin e Komunës së Prishtinës. Pra, kjo për çdo ditë është duke reflektuar në jetën e secilit.

Sa i përket raportit financiar dhe performancës së tremujorit të dytë, mendoj se qasjen duhem pasur tjetër, jo të kritikës dhe gjykimit, por të ndihmës.

**Halim Halimi** theksoi se nuk është vetëm çështja e pandemisë një prej arsyeve të mos realizimit të projekteve. Nëse kthehem te viti paraprak, edhe atëherë nuk e kemi pasur gjendjen e mirë dhe si pasojë e asaj gjendjeje, kemi pasur më se 27 milionë euro bartje, kështu që edhe vitin e kaluar kemi pasur 0% realizim të projekteve.

**Nol Nushi** tha se ky është raport, i cili ka të bëjë me muajt prill-maj-qershor, që në këta muaj pothuajse nuk është punuar fare, për shkak të situatës, andaj mendoj se ka qenë qasje konservatore, e stilit që në kriza të tillë ekonomike institucionet duhet me i stimuluar me shpenzuar, por jo me shpenzuar aty ku nuk duhet.

Duhet të insistojmë që secili, me aq ndikim sa kemi, që paraja publike me filluar me u shpenzuar. Disa projekte të mëdha tash veç janë në ekzekutim e sipër, si në lagjen "Dardania" dhe te "Qafa", po ashtu kanë filluar punimet në disa rrugë të qytetit.

Konsideroj se përballë këtij virusi jemi të rrezikuar të gjithë, por ne si institucione publike duhet me e bërë maksimumin që paraja publike me u shpenzuar sa më shumë, në sa më shumë projekte të mëdha që gjenerojnë sa më shumë punësim dhe sa më shumë qarkullim të parasë.

**Shefki Gashi**, sa i përket pjesës që ka të bëjë me pandeminë dhe gjendjen shëndetësore të qytetarëve, keni amnistit të plotë, por shikuar në realitet, në disa pjesë të qytetit, sidomos në infrastrukturën rrugore, nuk po punohet asgjë. Si shembull konkret mund ta marrim rrugën për Llukar, sidomos pjesa në dalje të qytetit, rrugë e cila është në gjendje shumë të keqe, e sidomos bëhet e pa kalueshme ditëve me shi. Kërkoi nga drejtoresha e Drejtorisë së Financave, që këtë shqetësim ta përcjellë tek ekzekutivi. Edhe projekt, i ujtit i paraparë përfurnizim me ujë të më se 26 fshatrave të komunës së Prishtinës, është më se i domosdoshëm realizim.

**Arbër Vokrri** tha se kur e shikojmë këtë buxhet, do të thotë raportin financiar, nuk mund të mos bie në sy kjo shifër, që tregon se totali i progresit për këta 2-3 muaj, d.m.th TM1 dhe tremujorin e dytë, figuron aty 7.10%, pra prej 1 milion e 190 mijë eurove përafërsisht sa kanë qenë të parapara, janë shpenzuar vetëm 84 mijë euro, pra kjo është e çuditshme!

Nëse i referohemi rubrikës "Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore", prej 150 mijë eurove të akorduara, figurojnë të harxhuara 800 euro. Prapë po them se kjo me siguri nuk përkon me atë çka së paku unë e kam parë, edhe pse kam qenë jo i kënaqur, e më herët shumë i pakënaqur se si është bërë alokimi i mjeteve përpajisjet e punëtorëve shëndetësorë me masa mbrojtëse dhe materiale mbrojtëse, e që më vonë është përmirësuar. Sugjerimi apo vërejtja ime është që, nëse këto shifra që na prezantohen në mënyrë zyrtare, në raportin e buxhetit nuk përkijnë me realitetin.

Ai propozoi që me e shqyrtuar mundësinë për shikimin e kapaciteteve njerëzore në Drejtorin e Shëndetësisë, përkatësish në institucionet shëndetësore të Komunës, duke kontraktuar shërbime, qysh e bëjnë edhe shumë komuna të tjera.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, e që ndërlidhen kryesisht me reportin financiar, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

**Agim Gashi** kërkoi të dijë se kur do të bëhen dezinsektimet në Prishtinë, pasi që qyteti është vërvshuar nga mushkonjat.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Gashi, sqarime të nevojshme dha Bujar Gashi, drejtor.

**Rifat Deri** tha se drejtoresha e Financave na ka sjellë informata të sakta dhe të mira, mirëpo duhet ta kemi një gjë parasysh, se të gjithë këtu ne jemi në situatë emergjente, kështu që të gjitha të hyrat, sa po shihet në tabelë, i kemi gjithsej të hyra për gjashtëmujor, ku janë 49.34% më pak se në vitin 2019, pra i kemi 50% të të hyra më pak, prandaj si mund të kemi dalje kur nuk kemi të hyra!

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të Kuvendit. Më 14 vota për, 5 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2020, (TM2).

#### Pika e pestë

#### Deklaratë për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së.

Leutrim Retkoceri bëri të ditur se kjo deklaratë është një nismë që është marrë edhe në kuvendet tjera komunale, dhe se qëllimi saj është të deklarohemi si Kuvend në mbrojtje të vlerave të UÇK-së, dhe të diskutojmë edhe për ngritjen e aktakuzës që është bërë këto ditë nga Gjykata, apo Dhomat e Specializuara në Hagë, në një mënyrë jashtëzakonisht absurde, që lenë për të dëshiruar. Ne e kuptojmë shumë mirë situatën e rëndë që po kalon vendi ynë me pandeminë COVID -19, e kuptojmë edhe një krizë ekonomike, mirëpo mendojmë që edhe kjo renditet në pjesën e krizës politike, për të cilën më vonë shpresoj që mos t'i ndiejmë edhe pasojat.

Para të pranishmëve ai e lexoi deklaratën, e cila përbëhet prej 8 pikave.

**Egzon Azemi** tha se, meqenëse sot me këtë datë po e diskutojmë këtë pikë të rendit të ditës dhe po diskutojmë për vlerat e luftës së UÇK-së, po besoj se është e rrugës fillimisht ta mbajmë një minutë heshtje për nder të të gjithë dëshmorëve të UÇK-së, e veçanërisht për nderë të katër dëshmorëve: Bedri Shala, Elton Zherka, Përmjet Vula dhe Bekim Berisha - Abeja, që sot e kanë përvjetorin e vdekjes, pra që janë dëshmorë dhe ndër figurat më eminente të luftës çlirimtare.

Nëse ju e doni mbështetjen tonë për ta votuar këtë deklaratë, propozoi që të hiqen dy emrat e apostrofuar në këtë deklaratë, të Kadri Veselit dhe të Hashim Thaçit, si dhe të

përmendet gabimi që është bërë në vitin 2015 për themelimin e Gjykatës Speciale. Në qoftë se nuk merren parasysh këto dy propozime, GP i LVV nuk do ta votojë këtë deklaratë.

Për këtë temë diskutuan edhe Halim Halimi, Vala Peshku, Fadil Gashi, Nol Nushi Shefki Gashi, Rifat Deri dhe Drilon Pireva, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 26 anëtarë të Kuvendit. Më 21 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Deklarata për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së.**

*Në mungesë të kuorumit, Kryesuesi e ndërpren mbledhjen.*

*Vazhdimi i mbledhjes së katërt, më 12.08.2020.*

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Bashkim Beha (PSD), Adrian Berisha (PSD), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDKKumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Valbona Petrovci (e pavarur). dhe Granit Shala (Nisma).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Vlora Dumoshi (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Qëndrim Sahiti (PSD), Besnik Mujeci (LVV), Naim Hoxha ( LVV), Nazlie Bala (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Sokol Berisha (i pavarur), Fikneta Bejta (e pavarur), Kreshnik Smajlaj (AAK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Florida Canolli (PDK).

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut.**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut.**

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Adrian Berisha, Arbër Vokrri, Halim Halimi, Fadil Gashi, Ardian Olluri, Agim Gashi, Nol Nushi, Sami Boroci, Rifat Deri dhe Shefki Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se në sallë janë 31 anëtarë të Kuvendit. Më 17 vota për, 5 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut.**

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi te Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.**

Për këtë pikë diskutuan Leutrim Retkoceri, Ardian Olluri, Adrian Berisha, Vala Peshku, Arbër Vokrri, Fadil Gashi dhe Halim Halimi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 30 anëtarë të Kuvendit. Më 22 vota për dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.**

#### **Pika e nëntë**

**Diskutim publik mbi Propozimrregulloren për definimin e parametrave urbanë, arkitektonik të ndërtimit dhe hapësirave gjelbëruese.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për diskutim publik mbi Propozimrregulloren për definimin e parametrave urbanë, arkitektonik të ndërtimit dhe hapësirave gjelbëruese.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-21449/20, dt. 28.02.2013.**

**Osman Bllaca tha se për shkak te gjendjes së pandemisë, këtë vit janë paraparë që nga taksat të lironen dy kategori të bizneseve, motelet dhe shërbimet hoteliere, ashtu janë të specifikuar më rregullore.**

Për këtë temë diskutuan Sami Boroci, Shefki Gashi, Agim Gashi, Leutrim Retkoceri, Rifat Deri, Vala Peshku dhe Leonora Shabani -Bajraktari, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin e vendimit të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-21449/20, dt. 28.02.2013.**

## **Pika e njëmbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje**

### **Kushtrim Sopa, pyetje dhe kërkesa:**

#### **Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave**

- A do të rregullohen shkallët afër objektit të Ministrisë së Shëndetësisë e cila lidh rrugën "Tirana" dhe atë "Bajram Curri" të lagjes "Arbëria", shkallë këto të cilat nuk janë renovuar që nga viti 1998.
- Gjendja e rrugëve është pothuajse në kolaps total, diku ka punime, diku prishje - intervenimet mungojnë sidomos 2 javët e fundit. A do të rritet numri i inspektorëve komunal të punës për të monitoruar punimet; a do të rregullohen pothuajse të gjitha rrugët në Kalabri (ish-"Emshiri"); do të rregullohen të gjitha rrugët në lagjen "Kolovica" me theks të veçantë rruga "Hasan Remniku" të cilën qytetarët po e mbajnë duke i mbyllur gropat me zhavorr; a do të rregullohen rrugët në lagjen "Arbëria" gjegjësisht rruga "Ahmet Dërguti" në drejtim të varrezave e cila është kinse duke u rinovuar, mirëpo punimet ekstremisht ngadalë po shkojnë ose pothuajse fare. Po në këtë rrugë pothuajse që 1 muaj rrjedhë pa ndal kanalizimi i lagjes i cili po shkakton kundërmim të tmerrshëm e sigurisht shpejtë edhe sëmundje tjera ngjitime infektive, ngase nuk po merret askush me të. Kërkesat dhe thirrjet e mia dhe të qytetarëve po hasin në vesh të shurdhër ose pothuajse fare nuk po merren parasysh. Probleme të tilla pas reshjeve të shumta ka pas në çdo cep të qytetit mirëpo kanë qenë të pakta ose fare intervenimet e institucioneve përkatëse me ç'rast shprehi pakënaqësinë dhe tërë mllefin për ndërgjegjen e ultë ose fare të udhëheqësve komunal.

#### **Për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm**

- A do të ketë lehtësime në qiranë të lokaleve që menaxhohen nga NPB, ngase ne si Komunë duhet të ju dalim në ndihmë bizneseve dhe afaristëve të ndryshëm në këtë kohë pandemie, për t'ua lehtësuar ose mundësuar ekzistencën e bizneseve të tyre edhe më tutje.

#### **Për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- Rroga "Mark Isaku" është rrugë njëkahore, ku zhvillohet qarkullim i dy anshëm (duhet urgjentisht intervenim infrastrukturor) duke i vendosur disa bregore apo pengesa tjera sepse voziqë është e sinjalizuar me shpejtësi mbi 60km/h, ndërsa aty duhet 30km/h, sepse shkolla "Meto Bajraktati" është afër dhe rreziku është evident për fëmijët.

#### **Për Kryetarin e Komunës**

- Bizneset janë të shqetësuara në lidhje me ndarjen e mjeteve për humbjet e tyre ekonomike, me ç'rast ne si Kuvend Komunal kemi votuar një pako të ndihmës për bizneset diku rrëth 5 milion euro, a do të ndahen ato mjete dhe kur.

#### **Për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit**

- A do të merren masa ndaj vozitësve të bicikletave të cilët i ngasin ato si të shfrenuar në vendet publike dhe shumë të frekuentuara si parqet e qytetit dhe sheshet kryesore të qytetit, ku jo shumë kohë më parë në Parkun e Qytetit një çiklist duke drejtuar bicikletën në shpejtësi marramendëse godet një fëmijë të vogël 3 vjeç dhe ai bie në tokë(gurë) me pjesën e pasme të

kokës, ku ai fëmijë pas shumë kohësh fatmirësisht shpëton mirëpo me trauma, lëndime dhe pasoja financiare (mjekësore) të prindërvë të këtij fëmije. Sigurisht nuk është rasti i parë dhe i fundit, a duhet ti parandalojmë këto veprime jo-njerëzore.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:45.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta

